



LËVIZËSIT E RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË MAL TË ZI

- rekomandimet për fuqizimin e rezistencës së komunitetit -





LËVIZËSIT E RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË MAL TË ZI

- rekomandimet për fuqizimin e rezistencës së komunitetit -

LËVIZËSIT E RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË MAL TË ZI

- rekomandimet për fuqizimin e rezistencës së komunitetit -

Botues:

Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ)

Redaktore:

Daliborka Uljareviq

Autor:

Petar Gjukanoviq

Perktheu:

Liridon Vulaj



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Publikimi është pjesë e projektit "Rrjeti i sigurtë" të cilin e realizon Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ) përmes Fondit për Qytetari Aktive (FQA) në kuadër të programit Për zë më të fuqishëm të shoqërisë civile! të cilin finansjarisht e përkrah Ambasada e SHBA-ve në Podgoricë.



fond za
aktivno građanstvo

Qëndrimet të paraqitura në këtë publikim i përkasin autorit dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht mendimin e FQA dhe Ambasadës së SHBA-së.

TË GJITHË NË FRONT KUNDRA RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terorizmi, si dhe qellimi i tyre perfundimtarë dhe më i vështirë, janë kërcënime serioze dhe sfidë për siguri dhe stabilitet të shoqërive bashkëkohore, nga të cilat nuk është i liruar as Mali i Zi. Përveç reagimit efektiv të shtetit, kundërveprimi ndaj këtyre fenomeneve kërkon veprimin e të gjithë aktorëve socialë - nga familja, përmes shkollës deri te shoqëria civile, përfshirë mediat, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e tyre.. Lufta efektive kundra radikalizimit me kornizë ligjislative, kriminalizimin e akteve penale dhe sistemit efikas të sanksionimit, por edhe aspektëve ushtarakë dhe të sigurisë, nënkupton përmirësim të vazhdueshëm të mbrojtjes së drejtave të njeriut, si dhe zhvillim të qëndrueshem ekonomik.

Edhe pse ende nuk ekziston një grup faktorësh që nxisin radikalizimin, për disa është vertetuar se kanë potencial veçanarisht të lartë që ta nxisin. Kushtet të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terorizmit, si eskalim të tyre, e të cilët janë të pranuar në nivel të Kombëve të Bashkuara dhe OSBE-së, përfshijnë konfliktet afatgjate të pazgjidhura mbrenda shoqërisë, sfidat me sundimin e ligjit, shkeljen e të drejtave të njeriut, diskriminimin etnik, kombëtarë, dhe fetarë, përjashtimin politik, marginalizimin socio-ekonomik dhe mungesën e administratës së mirë.

TË RINJËT - KUNDRA AMBIJENTIT TË VET DHE SHOQËRORË

Fatkeqësisht, këto janë të gjitha karakteristikat e shoqërisë malazeze, të pranishme si në perceptimin e qytetarëve ashtu edhe në situatën faktike, siç thuhet në raportet e shumta të organizatave vendase dhe ndërkombëtare që monitorojnë zhvillimin e Malit të Zi. Edhe pse zyrtarisht është anëtar i aleancës së NATO-s, dhe ka lëvizur shumë në fazën e negociatave me BE-në, Mali i Zi është ende një shtet i dobët në tiparet e tij. Ashtu si vendet përreth, Mali i Zi nuk është imun ndaj kërcënimit të radikalizimit. Dhe ai kërcënim është real, i përhapur dhe shumëdimensional.

Viteve të fundit shënohen norma të larta të papunësisë, si tek popullata e përgjithshme, ashtu edhe tek të rinjtë. Sipas të dhënave të fundit të Entit për Punësim Mali i Zi norma e përgjithshme e papunësisë është rreth 16%¹. Norma e papunësisë tek të rinjtë është edhe më drastike, vlerësimet tregojnë se ato sillen edhe mbi 35% në popullatën e përgjithshme të rinjëve, e bile mbi 5,000 me shkollë të lartë janë pa punë. Ndër ata të cilët janë të punësuar, karakteristikë e punësimit është puna e pasigurtë, punësimi në kohë të caktuar ose punësimi i përkohshëm, gjitha të cilët nuk garantojnë drejtimit e qëndrueshme të tranzicionit të të rinjëve në botën e të rriturve, shkaktojnë tek të rinjtë varësi të lartë banimi nga prindërit, ndërsa formimi i familjes dhe arritja në çdo aspekt tjetër personal dhe shoqërorë

¹ <http://www.zzzcg.me/>

shtyhet, e çka si pasojë shkakton edhe varfërinë dhe marginalizimin e të rinjëve². Gjithashtu, zgjatja e krizës ekonomike si pasojë, por edhe pasojat e normës së lartë të papunësisë, formojnë ndjenjën e pasigurisë sociale, posaçërisht tek të rinjtë dhe qytetarëve të cilët jetojnë në veri të Malit të Zi, e ajo përsëri paraqet teren pjellorë për zhvillimin e radikalizmit dhe eskalimin e tij. Hulumtimet e qendrimeve dhe vlerave të të rinjëve në Mal të Zi tregojnë nivel të ulët dhe shqetësues për interesimin e të rinjëve për çfarë do llojë aktivitetit shoqërorë, nga vullnetarizmi e deri tek angazhimi përmes aktivizimit politik, përkatësisht distancimin e fortë nga politika³. Pa të rinjtë si pjesëmarrës aktiv në jetën shoqërore dhe politike nuk ka as demokraci të qëndrueshme si sistem vlerash i cili është parandalimi më i mirë për rritjen e radikalizimit dhe paraqitjen e ekstremizmit të dhunshëm. Rritja e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit ndërmjet të rinjëve të cilat çojnë deri tek terrorizmi shpesh ka të bëjë me diskriminimin, perjashtimin dhe marginalizimin. Nxitja e ndjenjës së përkatësisë në shoqëri dhe inkurajimi i zhvillimit të angazhimit aktiv, qytetar dhe demokratik është thelbësore në luftën kundër radikalizmit.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se qytetarët në shumicë perceptojnë shoqërinë malazeze si diskriminuese, posaçërisht e theksojnë praninë e diskriminimit politik edhe atë në sferën e punësimit, qasjes në sistemin shëndetësorë dhe

arsimorë⁴. Perceptimi i diskriminimit në popullsinë e përgjithshme është i dukshëm edhe në kategorinë e të rinjëve, të cilët vlerësojnë se diskriminimi është i pranishëm në të gjitha sferat e jetës në Mal të Zi, por hulumtimet paralajmërojnë se qendrimet e tyre në shumë aspekte janë shumë diskriminues dhe perjashtues. Kjo veçanërisht referohet në qëndrimet ndaj homoseksualëve dhe pakicave tjera, të rinjëve të besimeve dhe etnive tjera të cilat janë të dukshme në distancën sociale dhe etnike. Kjo është posaçërisht e rrezikshme dhe shqetësuese duke marrë parasysh kontekstin multi-etnik të shoqërisë malazeze.

RRËNJËT NË POLITIKË, HISTORI TË RE DHE TRADITË

Mosdiskriminimi është posaçërisht i rëndësishëm në kontekstin e ndalimit dhe luftës kundër terrorizmit, të cilën e vertetojnë edhe shtetet anëtare të OSBE-së. Trajtimi diskriminues nga autoritetet publike mund të jetë një faktor që favorizon radikalizimin e dhunshëm dhe terrorizmin, dhe është e qartë se perceptime të tilla shprehen fuqimisht në mesin e qytetarëve. Personat të cilët janë të diskriminuar mund të ndjehen të tjetërsuar dhe, mbi këtë bazë, mund të jenë të prirur të besojnë se shoqëria dhe/ose shteti nuk i trajton ato në mënyrë të barabartë për shkak të, për shembull, dallimeve etnike, fetare ose gjuhësore, të cilat lehtë mund të çojnë në radikalizim.

² Gjukanoviq P. (2019), Studimi për të rinjtë në Mal të Zi 2018/19, Friedrich Ebert Stiftung

³ Gjukanoviq P. (2019), Studimi për të rinjtë në Mal të Zi 2018/19, Friedrich Ebert Stiftung

⁴ <http://cgo-cce.org/2019/02/28/perceptija-politicke-diskriminacije-sve-izrazenija/#.XTaY95MzZO5>

Mali i Zi gjatë viteve 90 nuk ka pas përvojë lufte në teritor të vet e cili ka percjellë shkatërrimin e RSFJ, por ka qenë pjesëtarë aktiv i ngjarjeve të luftës. Procesi i papërfunduar i ballafaqimit me të kaluarën dhe mungesa e efekteve në të drejtën tranzicionale paraqet barrë për zhvillimin shoqërorë dhe sfidë për qëndrueshmërinë e harmonisë multikulturore dhe religjioze. Kjo është e percjellur me mungesën e përpjekjeve serioze në arsim, për shembull në mënyrën e mësimin të historisë, që prodhon pasoja negative tek gjeneratat e reja. Ashtu që në vend të ripërtirjes së besimit të ndërsjelltë kemi rrezikun e formimit të ndarjeve të reja dhe thellimin e ndarjeve ekzistuese. Procesi i papërfunduar i ballafaqimit me të kaluarën krijon potencial për tenziona dhe paraqitjen e ideologjive dhe veprimeve të ndryshme radikale. Hulumtimet e vitëve të fundit shënojnë edhe norma vlerash jashtëzakonisht autoritative dhe tradicionale të orientueme si tek njerëzit në përgjithësi ashtu edhe tek të rinjtë. Ekziston një nivel i lartë i mosbesimit të përgjithshëm tek qytetarët dhe qëndrimi i të rinjve ndaj komunitetit më të gjerë dhe institucioneve të sistemit, gjë që tregon për kohezionin e brishtë shoqëror në Mal të Zi. Në aspektin e besimit, posaçërisht janë shqetësuese të dhënat të cilat tregojnë se të rinjtë janë më shumë të prirur sjelljeve të cilat janë problematike në shoqëri, si mashtrimi në provime, përdorimin e lidhjeve për kalimin e provimeve, "kryerjen e shërbimëve" në institucione publike, si dhe perceptimin se lidhjet, njohjet personale dhe lidhjet me të fuqishmit, si dhe përkatësia partiake janë faktorët kyç të cilët çojnë deri tek punësimi, etj⁵. Kohezioni shoqërorë i cili bazohet në besimin e

ndërsjelltë mund të çojë deri tek format e mobilizimit kolektiv, me personat të cilët janë të gatshëm të bëjnë përpjekjet e përbashkëta dhe të intervenojnë me qëllim të zgjedhjes së problemeve të përbashkëta për të mirën e të gjithëve. Niveli më i lartë i kohezionit shoqërorë lidhet me normën më të ulët të akteve penale si grabitjet, sulmet fizike, kriminalitetit në rruga dhe formave tjera të sjelljeve të cilat shkatërrojnë ndjenjën e sigurisë dhe bashkëjetesës.

MALI I ZI SOT – TEREN PJELLORË PËR ZHVILLIMIN E IDEVE RADIKALISTE DHE EKSTREMISTE

Të gjitha këto tregojnë se në shoqërinë malazeze ekziston potencial i lartë dhe i rrezikshëm për zhvillimin e ideve dhe ideologjive radikaliste dhe ekstremiste, çka është në kundërshtim me qëndrimin i cili shpesh theksohet, se jemi si shoqëri nga të gjitha shoqëritë e ballkanit apo postjugosllave më së paktit të rrezikuar nga këto fenomene. Shtetet e dobëta që nuk ofrojnë mundësinë e përfshirjes së plotë të qytetarëve, realizimin e nevojave dhe potencialeve, korrupsionit që nuk është gjë tjetër veçse shkelje masive e të drejtave të njeriut, sepse ata që kanë para janë të privilegjuar dhe janë të parët që kanë të drejta dhe shërbime, krijojnë ndjenjën e padrejtësisë, pasigurisë dhe shpresës që lehtë mund të çojë në radikalizëm..

Gjëndja e përgjithshme në shtet dhe shoqëri prodhon edhe pesimizem për një të nesërme më të mirë dhe perspektivë më të mirë të shoqërisë, çka na tregojnë edhe hulumtimet e perceptimit

5 Gjukanović P. (2019), Studimi për të rinjtë në Mal të Zi 2018/19, Friedrich Ebert Stiftung

të qytetarëve për lëvizësit e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm të cilen Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ) e ka bërë⁶. Hulumtimi, ndërmjet tjerash, konstaton se qytetarët janë gjysëm optimist dhe parashikojnë stagnim në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë, ndërsa një përqindje e vogël e atyre të cilët presin prosperitet. Të dhënat tregojnë se 7 deri 10 qytetarë konsiderojnë apo perceptojnë pozicionin e të rinjve në shoqëri si shumë të keq. Qendrimet ndaj pranisë së demokracisë në Mal të Zi janë, gjithashtu, të ndarë. Edhe pse është bindshëm pjesa e atyreve të cilët besojnë se principet e demokracisë janë të pranishme vetëm në leter, shumica konsiderojnë se ekziston liria e shprehjes së mendimit. Janë të ndara qendrimet edhe rreth rrespektimit të drejtave të njeriut dhe lirive, ndikimin e qytetarëve në proceset e prurjes së vendimeve në shtet, si edhe të asaj se sa punojnë institucionët në interes publik. Pak më shumë se e treta konsideron se ekzistojnë rastet e arsytimit për sistem të udhëheqjes jo demokratik, ndërsa e pesta e tyre ndjehet e pasigurtë në rrethin ku jeton. Është e evidentume rënia e besimit në institucione, rritja e besimit në shoqërinë civile (OJQ dhe mediat), dhe trendi i përgjithshëm i krizes së demokracisë reprezentative. Kisha tradicionalisht gjeneron shkallën më të

lartë të besimit, çka edhe imponon përgjegjësi më të madhe dhe nevojen e shoqërisë që liderët fetarë të kenë rol më të rëndësishëm në afirmimin e argumenteve kundra radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, promovimin e harmonisë dhe mirëkuptimit fetarë. Përveç diskriminimit politik i cili pozicionohet lart, qytetarët janë të prirur të besojnë se diskriminimi në bazë të statusit material është gjithnjë e më i pranishëm. Për dy të tretat e qytetarëve në Mal të Zi zbatimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike, shoqërore dhe religjioze nuk janë të arsyetueshme. Megjithatë, një e treta konsiderojnë se ekzistojnë rastet kur dhuna mund të jetë e arsyetueshme për arritjen e këtyre qëllimeve çka paraqet potencial për radikalizim dhe kërkon përgjigje preventive nga shumë sektorë. Është shumë e përhapur dhe pajtueshmëria me deklaratat se postulatet e besimit të vet do duhej të mbrohen me çdo çmim.

Individi i radikalizuem shpesh pranon dhe arsyeton përdorimin e fuqisë dhe dhunës si mënyrë që të ndërrojë nga rrënjët gjendjen aktuale në përputhshmëri me pamjet e fituara ideologjike, religjioze ose pamjeve tjera në botë me të cilat ndërkohë identifikohet. Sipas standardeve dhe treguesve statistikorë, situata e dobët socio-ekonomike në vend reflektohet në perceptimin e qytetarëve si sfida kryesore e shoqërisë, ashtu që ndër problemet më të mëdha me të cilat Mali i Zi sot ballafaqohet theksohen papunësia, ndjekur nga

⁶ <http://cgo-cce.org/2019/03/20/potencijal-za-radikalizaciju-postoji-i-potrebno-je-vice-raditi-na-prevenciji/#.XTaY1ZMzZOt>

kriminaliteti i organizuar, gjendja ekonomike e dobët, standardi jetësorë i keq, korupcioni dhe varfëria.

Interesante është se qytetarët në shumicë vlerësojnë se nuk janë të informuar për lajmërimet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe vlerësojnë se institucionet kompetente nuk punojnë boll në përmirësimin e ndërgjegjes së qytetarëve për kërcenimet dhe forcimin e rolit të tyre në parandalimin e këtyre fenomene në shoqëri.

Grupi qellues i ideologjive radikale dhe grupeve ekstremiste janë të pa punësuarit, të tjetërsuarit dhe individët e pashkolluar ose grupet e izoluara shoqërore, me ndjenjen e fortë shoqërore dhe ndjenjen se janë të tradhëtuar nga ana e shtetit. Për këtë është e nevojshme të forcohet funksioni i shtetit dhe kultura e shoqërisë e cila është përfshirëse, e hapur, demokratike dhe e bazuar në kulturen e të drejtave të njeriut, por edhe në ekonomi efikase dhe institucione të forta.

Të gjithave më sipër duhet t'i shtohen situatës sfiduese në fushën e arsimit, e cila është vlerësuar dobët nga renditjet përkatëse ndërkombëtare⁷. Përveç sistemit arsimorë i cili në përgjithësi

⁷ Për shembull, PISA testi Malin e Zi e vendos në fund të listës për nga kualiteti i shkrimit funksional të cilin të rinjtë e arrisin gjatë procesit arsimorë

nuk kultivon mendimin kritik, kemi edhe vendimin për heqjen e edukates qytetare si lëndë të rregullt dhe të obligueshme edhe në shkollat fillore, mandej mos ekzistimi i shkrim-leximi mediatik si lëndë të obligueshme në sistemin formal pavarësisht se gjithnjë e më shumë jemi të ekspozuar kërcenimeve nga lajmet e rrëjshme, propagandave ekstremiste dhe radikale, para së gjithash përmes medimeve moderne (interneti dhe rrjetet sociale). Këto kanë ndikimin e vet në rezistencën e dobët të komunitetit, e posaçërisht të rinjëve, në ndikimin e procesit të radikalizimi

STRATEGJIA 2016-2018 - KOHË PAK, NDARJA E PA QARTË E PUNES

Mali i Zi e ka kornizën strategjike për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Strategjia për shuarjen e ekstremizmit të dhunshëm 2016-2018 është aprovuar në fund të vitit 2015. Këtu janë caktuar qellimet kyçe strategjike: kuptimi i pershtatshëm i levizësve të ekstremizmit të dhunshëm që të veprohet në mënyre efektive, ndërtimi i sistemit koordinues institucional përgjegjës në sferën e parandalimit dhe ndalimit të paraqitjes së ekstremizmit të dhunshëm përmes zbatimit të aktiviteteve të qellueshme, zhvillimin e sistemit të percjelljes dhe evaluacionin e zbatimit të strategjisë, që në bazë saj të planifikohen aktivitetet në të ardhmen. Strategjia

është krijuar duke përdorë praktikat dhe eksperiencat më të mira të OSBE-së, Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian përmes veprimit të rrejtit për rritjen e ndërgjegjes për radikalizim EURA. Në prill të vitit 2016, është ndërtuar edhe plani percjellës i veprimit për zbatimin e strategjisë.

Vërejtja kryesore për këtë strategji të parë ka qenë afati teper i shkurtër për zbatim, sepse gjithsej 2 vite nuk janë të mjaftueshme për angazhimin efikas në këto tema komplekse për radikalizem dhe ekstremizem të dhunshëm. Gjithashtu, shpesh është cekur edhe ndarja e paqartë e kompetencave dhe përgjegjësive ndërmjet institucioneve të shumta të cilat kanë qenë të përfshira në realizimin e saj. Zyra për koordinim operativ pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila ka koordinuar zbatimin e Strategjisë dhe Planit veprues dhe në mars të vitit 2018 ka formuar ekipin operativ ndërmjet sektorëve të ndryshme për zbatimin e Planit veprues (NOT) i cili ka përfshier edhe përfaqësuesit e sektorit civil. Atëherë fillon të zhvillohet edhe komponenti parandalues i Strategjisë përmes fillimit të aktiviteteve të numërta në ngritjen e ndërgjegjes, lidhjen dhe forcimin e kapaciteteve të shoqërisë që të veprojnë në sferën e parandalimit të radikalizimit.

Gjithashtu, në nivelin e reagimit të shtetit, janë zhvilluar zgjidhje që janë përfshirë në Kodin Penal të Malit të Zi. Janë përcaktuar veprat penale të pjesëmarrjes në formacione të armatosura të huaja sipas nenit 449b, i cili inkriminon jo vetëm pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në frontet e huaja, por edhe për të gjithë ata që rekrutojnë luftëtarë të mundshëm të huaj dhe i mbështet financiarisht ato ose siguron logjistikë të tjerë. Është krijuar bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të

policisë dhe sigurisë, veçanërisht me INTERPOL dhe EUROPOL, por edhe me Kombet e Bashkuara përmes shkëmbimit të informacionit dhe monitorimit të përbashkët të lëvizjeve të personave dhe grupeve që mund të lidhen me terrorizmin.

Është punuar, gjithashtu, edhe në aktivitetet në sferën e permirësimit të sigurisë së komunikacionit ajrorë dhe kontrollit të udhëtarëve që në kohë dhe në përputhshmëri me standardet dhe konventat ndërkombëtare, të bëhet monitorimi i lëvizjeve të tyre, si dhe masat tjera parandaluese me të cilat kontrollohet hyrja e individëve dhe grupeve në vend, të cilët lidhen me organizata terroriste në vend. Është perforcuar shërbimi për kriminalitet kompjuterik dhe janë realizuar stërvitje të numërta të zyrtarëve për përdorimin e sigurtë të internetit, si dhe procedurat e përgjithshme të cilat do të duhej të çojnë deri tek lufta dhe eliminimi efikas i përmbajtjeve ekstremiste nga hapësira e internetit në bashkëpunim me NOT-in dhe operateret e internetit në Mal të Zi.

MUNDET DHE DUHET TË PUNOHET MË SHUMË

Shkalla e problemit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Mal të Zi pasqyrohet pjesërisht edhe në statistika, e cila thekson se, nga tetori i viti 2012 deri në fund të vitit 2018, në Siri kanë udhëtuar 23 nënshtetas të rritur malazez (18 meshkuj dhe 5 femra), bashkë me 3 fëmijë. Gjashtë meshkuj janë vrarë në Siri, ndërsa tre meshkuj, katër gra dhe dy fëmijë mbetën

në territorin e kontrolluar nga ISIL dhe një mashkull u arrestua në Turqi. Gjithsejt janë kthyer në Mal të Zi tetë meshkuj, një femer dhe një fëmi. Në Ukrainen Lindore në vitin 2014 kanë qëndruar disa nënshtetas të rritur malazez dhe të gjithë janë kthyer në Mal të Zi.

Pergjigja në sfiden e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm kërkon qasje gjithëpërfshirëse dhe afatgjate e cili nuk mbështetet vetem në aktivitete të drejtuara në sistemin e sigurisë, mbrojtjes, por përfshinë krejt shoqërinë dhe etiketon shkaqet bazë të këtij fenomeni. Në atë drejtim në dhjetorë të vitit 2018 është formuar rrjeti Së bashku kundra ekstremizmit të dhunshëm, e cila si platformë mbledh institucionet, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë në mënyrë që me veprim të përbashkët të punohet në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në kuadër të NOT-it janë formuar edhe shtatë RAN-a, grupe speciale të cilat nga aspektet e ndryshme, nga arsimi, deri tek siguria, merren me analizimin dhe zhvillimin e pergjigjeve efikase në radikalizem. Për nevojat e vazhdimin të aktiviteteve, NOT-i ka bërë edhe raportin për zbatimin e planit të veprimit për periudhën e mëparshme nga 2016-2018 dhe ka përpilua planin e veprimit për 2019 deri tek përpunimi i strategjisë së re për periudhën 2020-2024 e cila është planifikuar për çerekun e fundit të vitit 2019.

Kur të gjitha këto që janë përmendur lart analizohen, mund të thuhet se në disa vite të fundit merren disa masa të caktuara, por hapësirë për përmirësim ka ende, duke pasur parasysh kompleksitetin e sfidave, përkatësisht lëvizësit e radikalizimit me të cilat shoqëria ballafaqohet në mënyrë që të forcohet rezistenca e shoqërisë në kërcenimet e radikalizimit.

SI MË TEJ?

Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ) më shumë se 15 vite aktivisht avokon për shoqëri të qytetarëve përgjegjës dhe aktiv përmes kontributit për liri të mediave, ndërtimin dhe konsolidimin e institucionëve demokratike

dhe zhvillimin e kulturës së drejtave të njeriut, përmirësimin e gjendjes tek të rinjët, kontributin në zhvillimin e shoqërisë multietnike në aspekte të ndryshme, nga aktivitetet arsimore deri tek procesi i të drejtës tranzicionale dhe ballafaqimit me të kaluarën. Në atë drejtim, sugjerojmë disa aktivitete të cilat do të duhej të kontribuojnë në parandalimin dhe ndalimin e suksesshëm të eskalimit të radikalizimit dhe lajmërimit të ekstremizmit të dhunshëm. Institucionet shtetërore janë përgjegjëse për luftën kundra ekstremizmit të dhunshëm dhe terorizmit, por sistemi arsimorë, mediumet dhe shoqëria civile luajnë rrol kyç në parandalimin dhe vaksinimin e shoqërisë kundra fenomenëve të këtij llojit. Ata këtë e bëjnë, para së gjithash, duke zhvilluar kulturen e shoqërisë dhe dialogun ndërkulturor dhe promovimin e vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut kah parandalimi si një ndër segmentet kyçe në luftën kundra këtyre fenomenëve.

- Të përmirësohet efektiviteti në adresimin e faktorëve negativë socio-ekonomikë, siç është korrupsioni dhe mungesa e qeverisjes së mirë, janë një nga dobësitë më të mëdha të shtetit dhe shoqërisë;
- Të përmirësohet politika e punësimit e cila do të kontribuoj në zgjidhjen e normave të larta të papunësisë, posaçërisht tek të rinjët;
- Të punohet vazhdimisht në forcimin e politikave të cilat kanë të bëjnë me të rinjët dhe përmirësimin e gjendjes së përgjithshme shoqërore të tyre;
- Të përmirësohet komunikimi me grupe të caktuara, posaçërisht me të rinjët të cilët konsiderohen të ndjeshëm në indoktrinim dhe regrutim në organizatat ekstremiste të dhunshme;
- Të forcohen institucionet demokratike dhe sundimi i ligjit, të promovohet dialogu ndërmjet shtetit dhe shoqërisë (të forcohet partneriteti ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile) dhe të mundësohet respektimi i të drejtave dhe lirive elementare të njeriut;

- Shoqëria duhet të ofrojë alternativa të besueshme për ekstremizmin e dhunshëm, siç është zhvillimi dhe promovimi i aspekteve pozitive të mobilizimit shoqëror, siç është pjesëmarrja demokratike, angazhimi qytetar;

- Në kontinuitet të punohet në përmirësimin e strategjisë për luftën kundra jotolerances dhe diskriminimit, si dhe promovimin e respektit të ndërsjelltë, koegzistencen dhe harmoninë e marrëdhënieve ndërmjet grupeve etnike, gjuhësore, religjione dhe grupeve tjera në shoqëri;

- Forcimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë, qasje e barabartë dhe shërbime të larta publike në sferën e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera sociale për të gjithë;

- Promovimin e qasjes për zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore në çdo segment të shoqërisë;

- Të forcohet qasja e edukimit qytetarë në mënyrë që të përmirësohen kompetencat qytetare, kuptimi i rolit qytetarë dhe rëndësija e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore dhe politike, por edhe në kultivimin e vlerave qytetare;

- Përmirësimi i qasjeve arsimore ndaj shkrim-leximit mediatik, si për përdorimin e mediave tradicionale ashtu edhe për të ashtuquajturat media sociale, të gjitha në mënyrë që të krijojnë konsumatorë kritikë të përmbajtjes së mediave, të cilët janë të vetëdijshëm për rreziqet dhe dinë të përdorin me mençuri media të reja, i rezistojnë radikalizimit dhe rekrutimit përmes internetit, lajmeve të

- rrreme dhe propagandës tjetër të lëvizjeve ekstremiste dhe radikale dhe individëve

- Të punohet në përmirësimin e qasjes në arsim i cili nxit mendimin kritik tek të rinjtë, që të forcohet rezistenca e tyre në indoktrinim, manipulim dhe kuptimin e stereotipeve dhe paragjytimeve;

- Të përmirësohet efikasiteti i procesit të drejtës tranzicionale përmes procesimit adekuat dhe sanksionimit të krimeve të luftes në mënyrë që të ndërtohet besimi ndërmjet komuniteteve, marrëdhëniet e të cilëve janë të ngarkuara me trashigimin e luftes;

- Të përmirësohet procesi i të drejtës tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën përmes mësimin të historisë dhe afirmimit të vlerave antifashtiste tek të rinjtë;

- Forcimin e kohezionit shoqërorë përmes përmirësimin të funksionimit të institucioneve me pergjegje në korupcion, nepotizëm, fenomene dhe sjellje tjera të cilat janë të dëmshme për shoqëri;

- Të forcohet roli i mediave në hulumtime dhe raportime objektive dhe profesionale për temat të cilat kanë të bëjnë me radikalizem dhe ekstremizem të dhunshëm, si dhe në përgjithësi për zhvillimin e ambijentit për gazetari profesionale dhe kritike duke garantuar standardet më të larta të lirisë së shprehjes;

- Forcimin e rolit të mediave në promovimin e argumenteve kundra radikalizimit dhe promovimin e shembujve individual

dhe shoqërorë të cilët kontribuojnë në luftën kundra radikalizimit, hapin mesazhe tolerance, mirekuptimit dhe paqes së ndërsjelltë;

- Forcimin e arsimimit dhe edukimit për kuptim ndëretnik dhe religjioz dhe heqjen e interpretimeve të thjeshtëzuara dhe kuptimin e ekstremizmit të dhunshëm si fenomen fetarë i lidhur vetem me grup/e, besim/e të caktuara;

- Promovimi i qasjes në arsim që përmes mësimdhënies dhe në jetën e përgjithshme të shkollave dhe të promovojë vlera pozitive shoqërore, tolerancën, hapjen dhe gjithëpërfshirjen në mënyrë që të prishen narracionet e ekstremizmit të dhunshëm;

- Rritja e vazhdueshme e aftësisë së stafit mësimdhënës për të zbuluar simptomat e ekstremizmit të dhunshëm në një fazë të hershme, dhe t'u sigurojë atyre mjete për të fuqizuar studentë të prirur për t'u përballur dhe sfiduar vetë ekstremizmin e dhunshëm;

- Forcimin e bashkëpunimit të shkollës dhe prindërve në parandalimin e radikalizimit;

- Të nxitet përfshirja sociale e të rinjëve përmes volonterizmit dhe mbështetjae organizatave dhe iniciativave rinore, si dhe të përmirësohet oferta për

perdorimin aktiv dhe produktiv të kohës së lirë dhe pjesëmarrja e të rinjëve në prurjen e vendimeve;

- Përkrahje për forcimin e kapaciteteve dhe kampanjës për të kundërshtuar gjuhën e urrejtjes, dhunës në internet dhe në përgjithësi dhunës moshatare ndërmjet të rinjëve të cilët kontribuojnë në njohjen e rolit të vet dhe përfshirjen aktive të të rinjëve në këto aktivitete;

- Zgjerimin e vazhdueshëm të hapësirës për angazhim të përbashkët dhe veprim të institucioneve qeveritare dhe dialog me shoqërinë civile në formimin e politikave, strategjive dhe evaluacionin e tyre;

- Zhvillimin e vetëdijes për shkaktarët potencial të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm ndërmjet qytetarëve, e posaçërisht të rinjëve, si dhe forcimin e kuptimit të rolit të tyre në proceset në shtypjen e këtyre fenomeneve, me regulativa institucionale dhe ligjore dhe mundësinë e bashkëpunimit me institucione dhe media.

